



Master në
“BUSINESS INFORMATICS”
me profile

a) Zhvillim Software dhe Sisteme Biznesi

b) Data Science dhe Inteligjencë Artificiale në Ekonomi

Pse të zgjidhni një Master në Informatikë Biznesi?

- I zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin BOKU, programi i përgjigjet nevojave aktuale të tregut të punës dhe trendeve të transformimit digjital në ekonomi, agrobiznes, shërbime dhe administratë publike
- Integron shkencat kompjuterike, proceset e biznesit, analizën e të dhënave dhe inteligjencën artificiale në një kuadër të unifikuar ndërdisiplinor
- Zhvillon kompetenca të avancuara në programim, inxhinieri software dhe sisteme biznesi, të përshtatura me kërkesat e bizneseve moderne
- Përgatit të diplomuarit për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në të dhëna dhe për të nxitur inovacionin në mjedise digjitale në institucione dhe biznese

Kompetencat e të diplomuarve

I. Informatikë Biznesi: Profili “Zhvillim Software dhe Sisteme Biznesi”

- Zhvillojnë aplikacione software dhe platforma digjitale (web, mobile, enterprise) për mbështetjen e gjurmimit të prodhimit, logjistikës, menaxhimit financiar dhe marketingut në ekosistemin e agrobiznesit
- Projektojnë dhe implementojnë zgjidhje të avancuara për menaxhimin e të dhënave, përfshirë databazat, data warehouse dhe data mining, për integrimin dhe analizën e informacionit përgjatë zinxhirit të vlerës
- Aplikojnë teknologji të sigurisë kibernetike, cloud computing dhe platforma digjitale, përfshirë zgjidhje të bazuara në AI për e-governance, duke garantuar operacione të sigurta dhe efikase
- Projektojnë dhe zhvillojnë sisteme të inteligjencës së biznesit dhe sisteme mbështetëse të vendimmarrjes për të mbështetur planifikimin strategjik, parashikimin e tregut, menaxhimin e rrezikut dhe inovacionin në ekonomi, agrobiznes dhe sektorët e lidhur me to.

II. Informatikë Biznesi: Profili “Data Science dhe Inteligjencë Artificiale në Ekonomi”

- Aplikojnë modele ekonometrike, analiza parashikuese dhe teknika të big data për të analizuar trendet, rreziqet dhe treguesit e performancës në agrobiznes dhe sistemet ekonomike
- Zhvillojnë dhe aplikojnë modele të machine learning dhe inteligjencës artificiale për të simuluar skenarë ekonomikë, për të optimizuar proceset e prodhimit dhe për të përmirësuar vendimmarrjen

- Projektojnë mjete të vizualizimit të të dhënave dhe dashboard-e interaktive për të mbështetur interpretimin e të dhënave dhe vendimmarrjen e informuar të aktorëve të interesuar
- Përdorin teknologji të avancuara të përpunimit të të dhënave, modele simulimi dhe zgjidhje të inteligjencës artificiale gjeneruese për të mbështetur analizën financiare, marketingun digjital dhe inovacionin në agrobiznes dhe sektorët ekonomikë

Punëdhënës të mundshëm dhe/ose drejtime kariere

- Punësim në kompani software, departamente IT të ndërmarrjeve, kompani agrobiznesi, institucione financiare, kompani konsulence dhe organizata të sektorit publik si zhvillues software, inxhinierë software, zhvillues sistemesh dhe specialistë IT
- Punësim në njësi analize të të dhënave, kërkimi dhe inovacioni si data scientist, specialistë të inteligjencës artificiale, analistë të të dhënave ekonomike dhe specialistë Business Intelligence, duke aplikuar teknika të avancuara analitike dhe modeluese
- Punësim në mjedise infrastrukturore dhe sisteme enterprise si administratorë databazash, specialistë cloud, inxhinierë infrastrukture IT dhe specialistë të sistemeve ERP/CRM, duke menaxhuar sisteme digjitale të sigurta dhe të shkallëzueshme
- Punësim në konsulencë, biznes dhe administratë publike si analistë IT biznesi, konsulentë të transformimit digjital, specialistë të e-shërbimeve dhe këshilltarë për inovacion, duke mbështetur optimizimin e proceseve dhe inovacionin digjital

Alumni dhe përvoja profesionale

Alban Stambolliu – Zhvillues Software në shërbimet e e-Government në KreatX; doktorant në “Ekonomi dhe Agrobiznes”; Staf akademik me kohë të pjesshme në FEA/AUT

Kam përfunduar studimet në Informatikë Biznesi në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Aktualisht punoj si zhvillues software në shërbimet e qeverisjes elektronike në KreatX, duke kontribuar në zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjeve digjitale për shërbimet e sektorit publik. Paralelisht, ndjek studimet e doktoraturës në “Ekonomi dhe Agrobiznes” në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe jam i angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme, duke kontribuar në mësimdhënie dhe aktivitete akademike në fushën e informatikës.

Haire Gjonaj – Master në “Informatikë Biznesi”, Analiste Biznesi & Konsulente në Galaxy sh.p.k.; Staf akademik me kohë të pjesshme në FEA/AUT

Përfaqësoj profilin e një analisteje biznesi me një formim të fortë ndërdisiplinor në informatikë biznesi, duke kombinuar ekspertizën në programim, analizë të të dhënave dhe procese biznesi. Përmes studimeve dhe përvojës profesionale, jam angazhuar në analizimin e kërkesave të biznesit, testimin e sistemeve digjitale dhe mbështetjen e implementimit të zgjidhjeve teknologjike në përputhje me objektivat e transformimit digjital. Gjithashtu, jam e angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme në Universitetin Bujqësor të Tiranës, duke kontribuar në mësimdhënie dhe aktivitete akademike në fushën e informatikës.

Joli Dura – Specialiste në Drejtorinë e Programimit dhe Zhvillimit, AKSHI; Staf akademik me kohë të pjesshme në FEA/AUT

Kam zhvilluar kompetenca të forta në zgjidhjen e problemeve ekonomike përmes identifikimit, analizës, zhvillimit dhe implementimit të zgjidhjeve të bazuara në sistemet e informacionit. Formimi im akademik dhe përvoja profesionale përfshijnë gjithashtu aftësi të avancuara në planifikimin analitik, strategjik dhe kërkimor, si dhe në menaxhimin e projekteve, duke më mundësuar trajtimin e sfidave komplekse në mjedise biznesi dhe ekonomike. Aktualisht punoj si specialiste në Drejtorinë e Programimit dhe Zhvillimit në AKSHI, ndërkohë që kontribuoj edhe si staf akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Xhoana Ukaj – Specialiste në Drejtorinë e Infrastrukturës së e-Government, AKSHI; Staf akademik me kohë të pjesshme në FEA/AUT

Jam specialiste në infrastrukturën e qeverisjes elektronike në AKSHI, ku kontribuoj në zhvillimin, menaxhimin dhe optimizimin e sistemeve digjitale që mbështesin shërbimet publike. Kam përfunduar studimet në Informatikë Biznesi në Universitetin Bujqësor të Tiranës, të cilat më kanë pajisur me një formim të fortë ndërdisiplinor në sistemet e informacionit dhe teknologjitë digjitale. Paralelisht, jam e angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, duke kontribuar në mësimdhënie dhe aktivitete akademike në fushën e informatikës.

Ndërdisiplinarteti i programit

- Rreth 15% e kurrikulës i dedikohet Shkencave Natyrore, duke mbështetur mendimin analitik dhe kuptimin e sistemeve që lidhen me agrobiznesin dhe mjedisin
- Rreth 25% e kurrikulës fokusohet në Shkencat Socio-Ekonomike, duke forcuar kompetencat në ekonomi, menaxhim dhe procese vendimmarrjeje
- Rreth 60% e kurrikulës i dedikohet Shkencave Teknike, duke përfshirë programimin, analizën e të dhënave, inteligjencën artificiale dhe sistemet e informacionit
- Shembujt praktikë, studimet e rasteve dhe projektet janë të orientuara drejt agrobiznesit dhe agro-industrisë, duke siguruar zhvillimin e kompetencave të aplikuara dhe specifike për sektorin

Programi Master në Informatikë Biznesi është konceptuar mbi një qasje ndërdisiplinore që integron inovacionin teknologjik, analizën e të dhënave, parimet ekonomike dhe menaxhimin e biznesit. Kjo qasje e integruar u mundëson studentëve të përballen me sfida komplekse reale dhe mbështet zhvillimin e zgjidhjeve inovative të bazuara në të dhëna. Programi përfaqëson një model modern arsimor që përgatit të diplomuarit për profesione të reja me kërkesë në rritje në tregun e punës, veçanërisht në kontekstin e transformimit digjital të ekonomisë, agrobiznesit dhe sektorëve të lidhur me të.

Kush mund të aplikojë në këtë program Master

- Të diplomuar në Informatikë Biznesi, Informatikë, Shkenca Kompjuterike ose fusha të ngjashme ICT
- Të diplomuar në Ekonomiks, Menaxhim Biznesi, Financë me interes për transformimin digjital dhe sistemet e informacionit
- Të diplomuar në inxhinieri ose fusha të tjera teknike me njohuri bazë në matematikë, statistikë ose programim
- Kandidatë me kompetenca bazë në metoda kuantitative, analizë të të dhënave ose programim, të motivuar për të zhvilluar aftësi ndërdisiplinore në ndërthurjen e teknologjisë me biznesin